



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.1103/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesat e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Prizrenit dhe Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, Dega në Komunën e Prizrenit, paraqitur kundër këshillave të vendotimeve në Komunën e Prizrenit, për shkak të parregullsive gjatë ditës së votimeve, që ka të bëjë me votat e shpallura si të pavlefshme të pa plotësuara (të zbrazëta), dhe rinumërimin e votave, për Rundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale të datës 19.11.2017, për Kryetar të Komunës në Prizren, në seancën e panelit të mbajtur, me datë 22.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. PRANOHEN si të bazuara ankesat e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja dhe Partia Demokratike e Kosovës (PDK), që të dyja, me seli në Prishtinë, Dega në Prizren ZL.Anr. 1103/2017 dhe ZL.Anr.1108/2017 të datës 20.11.2017, me të cilat është kërkuar që të rivlerësohen fletëvotimet e pavlefshme, fletëvotimet e përdorura nga votuesit por te pa plotësuara (të zbrazëta), të cilat kanë qenë në kutin e votimit dhe të rinumërohen të gjitha fletëvotimet e rregullta.

II. URDHËROHET Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, ti rivlerëson fletëvotimet e pavlefshme, fletëvotimet e përdorura nga votuesit por te pa plotësuara (të zbrazëta), të cilat kanë qenë në kutin e votimit dhe të rinumërohen të gjitha fletëvotimet e rregullta në këto Vendvotime të Komunës së Prizrenit:

2001A/01R	2003A/02R	2004A/03R	2005A/07R	2006A/03R
2001A/02R	2003A/03R	2004A/04R	2005A/08R	2006A/04R
2001A/03R	2003A/04R	2004A/05R	2005A/09D	2006A/05D
2001A/04R	2003A/05R	2004A/06R	2005X/01R	2006X/01R
2001A/05D	2003A/06R	2004A/07R	2005X/02R	2006X/02R
2002A/01R	2003A/07R	2004A/08D	2005X/03R	2006X/03R
2002A/02R	2003A/08R	2005A/01R	2005X/04R	2006X/04D
2002A/03R	2003A/09R	2005A/02R	2005X/05R	2007A/01R
2002A/04R	2003A/10R	2005A/03R	2005X/06R	2007A/02R
2002A/05R	2003A/11D	2005A/04R	2005X/07D	2007A/03R
2002A/06D	2004A/01R	2005A/05R	2006A/01R	2007A/04R
2003A/01R	2004A/02R	2005A/06R	2006A/02R	2007A/05R

2007A/06D	2022A/01D	2037A/02D	2042A/33D	BM220/002
2008A/01R	2023A/01R	2038A/01R	2043A/01D	CB120/001
2008A/02R	2023A/02R	2038A/02D	2044A/01D	CB120/002
2008A/03R	2023A/03R	2039A/01R	2045A/01D	CB120/003
2008A/04R	2023A/04R	2039A/02D	2046A/01D	CB120/004
2008A/05R	2023A/05D	2040A/01R	2047A/01D	CB120/005
2008A/06D	2024A/01R	2040A/02D	2048A/01D	CB120/006
2009A/01R	2024A/02D	2041A/01R	2049A/01R	CB120/007
2009A/02R	2025A/01R	2041A/02D	2049A/02D	CB120/008
2009A/03R	2025A/02R	2042A/01R	2050A/01R	CB120/009
2009A/04R	2025A/03D	2042A/02R	2050A/02D	CB220/001
2009A/05D	2026A/01R	2042A/03R	2051A/01D	CB220/002
2010A/01D	2026A/02R	2042A/04R	2052A/01D	CB220/003
2011A/01R	2026A/03R	2042A/05R	2053A/01D	CB220/004
2011A/02R	2026A/04D	2042A/06R	2054A/01D	CB220/005
2011A/03D	2027A/01R	2042A/07R	2055A/01D	CB220/006
2012A/01R	2027A/02D	2042A/08R	2056A/01D	CB220/007
2012A/02D	2028A/01D	2042A/09R	2057A/01D	CB220/008
2013A/01R	2029A/01R	2042A/10R	2058A/01D	CB220/009
2013A/02R	2029A/02D	2042A/11R	2059A/01R	
2013A/03R	2030A/01R	2042A/12R	2059A/02D	
2013A/04D	2030A/02R	2042A/13R	2060A/01D	
2014A/01R	2030A/03D	2042A/14R	2061A/01R	
2014A/02D	2031A/01D	2042A/15R	2061A/02D	
2015A/01R	2032A/01R	2042A/16R	2062A/01R	
2015A/02R	2032A/02D	2042A/17R	2062A/02D	
2015A/03R	2033A/01R	2042A/18R	2065A/01R	
2015A/04R	2033A/02R	2042A/19R	2065A/02D	
2015A/05D	2033A/03R	2042A/20R	2066A/01D	
2016A/01R	2033A/04R	2042A/21R	2067A/01R	
2016A/02D	2033A/05R	2042A/22R	2067A/02D	
2017A/01D	2033A/06R	2042A/23R	2068A/01R	
2018A/01R	2033A/07D	2042A/24R	2068A/02D	
2018A/02R	2034A/01R	2042A/25R	2069A/01D	
2018A/03D	2034A/02D	2042A/26R	2070A/01D	
2019A/01D	2035A/01R	2042A/27R	2071A/01D	
2020A/01R	2035A/02R	2042A/28R	BM020/001	
2020A/02R	2035A/03D	2042A/29R	BM020/002	
2020A/03D	2036A/01R	2042A/30R	BM120/001	
2021A/01R	2036A/02D	2042A/31R	BM120/002	
2021A/02D	2037A/01R	2042A/32R	BM220/001	

III. VLERËSIMI i Votave të pavlefshme dhe rishikimi i votave të hedhura si të pa plotësuar, të bëhet konform, Doracakut - I Procedurave të votimit dhe numërimit të KQZ-së, për vlerësimin e fletëvotimeve të vlefshme dhe të pavlefshme, në prezencën e vëzhguesve të

subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, vëzhguesve nga subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës, vëzhguesve të interesuar nga organizatat e akredituar për vëzhgim të procesit zgjedhor nga KQZ-ja, për këto zgjedhje dhe mediave.

IV. REZULTATI që del nga vlerësimet e bëra si në pjesën e II të dispozitivit të këtij vendimi, duhet të përfshihet me rastin e shpalljes në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve, nga KQZ-ja.

Arsyetim

Me datën 20.11.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, e cila identifikohet me shenjën ZL.Anr.1103/2017, me të cilën thekson se me 19 nëntor 2017, në Qendrën e Votimit "Luciano Matrioni" në Prizren, konkretisht në vendvotimin 2008A/01R, kryesuesi i këtij vendvotimi, Flamur Rezi, pasi ka numëruar votat në këtë vendvotim, konkretisht gjatë shënimit të votave të kandidatëve për Kryetar të Komunës së Prizrenit, ka bërë një gabim teknik duke ja ndërruar numrin e votave kandidatëve në këtë Komunë, ku Mytahir Haskuka i cili ka marrë 174 vota ju kanë përshkruar kandidatit të PDK-së, Shaqir Totaj, ndërsa votat e kandidatit Shaqir Totaj i cili ka marrë gjithsej 119 vota ju kanë përshkruar në Formularin e Rezultateve kandidatit të LVV-së Mytahir Haskuka. Më tej kanë theksuar se këtë dëshmi, Flamur Rezi në cilësinë e kryesuesit të Qendrës së Votimit "Luciano Matrioni, në Prizren e ka përshkruar edhe në Raportin e KKZ-së mbi pranimin e materialeve. Andaj në bazë të nenit 101.1 dhe 102.2 të LZP-së dhe nenit 21.1 të Rregullës 9/2013 të KQZ-së kërkojnë nga PZAP-i që votat në vendvotimin nr. 2008A/01R të rinumërohen me qëllim të evitimit të gabimit teknik.

PZAP-i më datë 20.11.2017, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, Dega në Komunën e Prizrenit, e cila identifikohet me shenjën ZL.Anr.1108/2017, me të cilën ka kërkuar me të cilën ka kërkuar që të rivlerësohen fletëvotimet e pavlefshme, fletëvotimet e përdorura nga votuesit por te pa plotësuar (të zbrazëta) të cilat kanë qenë në kutin e votimit dhe te rinumërohen te gjitha fletëvotimet e rregullta në Komunën e Prizrenit, ngase sipas parashtruesit të ankesës ka pas parregullsi të cilat kanë ndikuar në rezultat të kandidatëve për kryetar të kësaj komune. Me propozim për panelin që ankesa të aprovohet në tërësi si e bazuar.

Paneli i PZAP-it, në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurat e PZAP-it, ka bashkuar ankesat dhe i ka trajtuar si një ankesë të evidentuar me ZL Anr. 1103/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve ankimore, dhe për të gjitha ankesat vendosi me një vendim, për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të ankesave dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, si dhe vlerësimit te provave te bashkangjitura ne ankesa në kuptim të nenit 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesat janë te bazuar:

Paneli gjatë vlerësimit të pretendimeve ankimore në ankesa si dhe provave të bashkangjitura gjeti se pretendimet ankimore të ankuesve janë të bazuara, duke pas parasysh numrin e madhe të fletëvotimeve të pavlefshme dhe të zbrazëta dhe veçanërisht rezultatin e ngushtë në mes të dy kandidatëve dhe mospërputhjeve të shumta të votave të pavlefshme dhe të zbrazëta. PZAP-i, vlerëson se këto të dhëna me parregullsitë e theksuara më lart, do të kenë ndikim në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve, andaj me qëllim të eliminimit të çdo dyshimi dhe për të ruajtur besimin dhe transparencën në procesin zgjedhor PZAP-i, urdhëron KQZ-në, që në të gjitha vendvotimet e cekura në pjesën e II të dispozitivit të këtij vendimi, të rivlerëson dhe rinumëron fletëvotimet e **pavlefshme**, fletëvotimet e përdorura nga votuesit **por të pa plotësuar** (të zbrazëta), të cilat kanë qenë në kutin e votimit dhe të rinumërohen të gjitha **fletëvotimet e rregullta** në të gjitha Qendrat e Votimit në Komunën e Prizrenit.

Vendimi i PZAP-it ka mbështetje të nenit 106 par.2 të LZP-së, ku përcaktohet: “*Para certifikimit të rezultatin të zgjedhjeve, KQZ-ja mund të urdhërojë rinumërimin e votave në cilindo vendvotim, qendër të numërimit ose edhe përsëritjen e votimit në një qendër votimi apo në një komunë*”

PZAP-i, me qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura vendimin e ka bazuar në nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vlerësimi i votave të pavlefshme dhe rishikimi i votave të hedhura si të pa plotësuar, duhet të bëhet konform, Domëkakut të Procedurave të votimit dhe numërimit të KQZ-se, për vlerësimin e fletëvotimeve të vlefshme dhe të pavlefshme, dhe me qëllim të transparencës rinumërimi dhe rishikimi i votave duhet të bëhet në prezencën e vëzhguesve të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja, vëzhguesit nga Partia Demokratike e Kosovës, vëzhguesve të interesuar nga organizatat e akredituar për vëzhgim të procesit zgjedhor nga KQZ-ja, për këto zgjedhje dhe mediave.

Rezultati që del nga vlerësimet e bëra si në pjesën e II të dispozitivit, të këtij vendimi, duhet të përfshihet me rastin e shpalljes në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve, nga KQZ-ja.

Andaj, Paneli në kuptim të nenit 117, 118 dhe nenit 120 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.1103/2017 me datën 22.11.2017

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi Gjykatës Supreme të Kosovës.

